



Funded by  
the European Union

# Udhëzues për Monitorim të Ndjeshëm Gjinor të Gjykatave në Rastet e Dhunës në Baza Gjinore

---

Tetor 2025



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE



Funded by  
the European Union

Grupi për Studime Juridike dhe Politike  
"Rexhep Luci" str. 16/1  
Prishtina 10 000, Kosovo  
Website: [www.legalpoliticalstudies.org](http://www.legalpoliticalstudies.org)  
E-mail: [office@legalpoliticalstudies.org](mailto:office@legalpoliticalstudies.org)  
Tel/fax.: +381 38 234 456

# Udhëzues për Monitorim të Ndjeshëm Gjinator të Gjykatave në Rastet e Dhunës në Baza Gjimore

## Deklaratë mohimi:

Ky manual është prodhuar në kuadër të projektit me titull: "Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në luftimin e pabarazisë sociale dhe dhunës me bazë gjimore në Kosovë", i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Grupit për Studime Juridike dhe Politike dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

© Grupi për Studime Juridike dhe Politike, Tetor 2025.



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE

# Përmbajtja

Hyrje	4
Pse duhet të kemi një dimension gjinor në monitorim të seancave gjyqësore në rastet e DhBGj-së?	5
Baza ligjore	6
Disa nocione kyçe	8
Çka të kërkojmë në seancat gjyqësore?	10
Çka të kërkojmë në aktgjykime?	12

## > Hyrje

Ky udhëzues është krijuar si produkt i projektit Just React 2.0 (titulli i plotë: "Fuqizimi i rolit të shoqërisë civile në luftimin e pabarazisë sociale dhe dhunës me bazë gjinore në Kosovë"), i financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i tij është të shërbejë si udhërrëfyes për monitoruesit/et e projektit, profesionistët/et e ri/reja, studentët/et dhe akterët e tjerë që do të përfshihen në monitorim të gjykatave në zgjidhjen e rasteve të dhunës në baza gjinore (DhBCj). Udhëzuesi parasheh të shërbejë si burim bazik i informatave për monitorim të ndjeshëm gjinor, duke ofruar bazën ligjore, konceptet themelore, si dhe pyetje e indikatorë konkretë të cilët mund të masin dhe adresojnë dinamikat gjinore gjatë seancave gjyqësore.

Monitorimi i ndjeshëm gjinor është esencial për të siguruar që sistemet e drejtësisë janë gjithëpërfshirëse, të drejta, dhe u shmangen paragjytimeve gjinore të (pa) vetëdijëshme. Fatkeqësisht, gjykatat nuk janë imune ndaj normave patriarkale apo mangësive institucionale. Përkundrazi, janë këto institucione ato që nganjëherë i ritheksojnë këto norma. Prandaj, ky udhëzues tenton të pajisë monitoruesit/et me mjete e pyetje praktike që shtojnë një pikëpamje gjinore, përveç monitorimit të zbatimit të legjislacionit procedural e substantiv.

Ky udhëzues përfshinë:

- Një pasqyrë të legjislacionit vendor dhe ndërkombëtar për dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje;
- Përshkrime bazë të koncepteve themelore gjinore të ndërlidhura me dhunën me bazë gjinore
- Shembuj konkret të elementeve me dimension gjinor që mund të monitorohen gjatë seancave.



# ➤ Pse duhet të kemi një dimension gjinor në monitorim të seancave gjyqësore në rastet e DhBGj-së?

Për dy arsye kryesore.

E para, DhBGj prekë gratë në mënyrë joproporcionale, dhe monitorimi duhet të reflektojë këtë.

DhBGj nuk është një fenomen neutral në gjini, gratë janë shumë më shumë të prekura nga ky fenomen sesa burrat. Sipas të dhënave nga UN Women, 1 në 3 gra përjeton një apo më shumë forma të DhBGj-së gjatë jetës së tyre.<sup>1</sup> Ndërsa sipas një ankete të OSBE-së (2019), në Kosovë, 54% e grave të anketuara kanë shprehur se kanë përjetuar një apo më shumë forma të DhBGj-së nga mosha 15 vjeçare.<sup>2</sup> Në anën tjetër, në Bashkimin Evropian, 1 në 5 gra përjetojnë dhunë nga partneri intim së paku një herë gjatë jetës së tyre.<sup>3</sup> Duke parë këto të dhëna, kuptojmë se është shumë e rëndësishme që sistemi gjyqësor që trajton viktimat të jetë i përgjegjshëm në pikëpamje gjinore, duke siguruar që nevojat, përvojat dhe ndjeshmëritë e të mbijetuarave të jenë në qendër.

E dyta, sistemi gjyqësor ndikohet nga normat patriarkale që vazhdojnë të formësojnë funksionimin e institucioneve.

Sistemi gjyqësor nuk mund të funksionojë në vakum nga pjesa tjetër e shoqërisë që është tejet e prekur nga normat patriarkale. Gjyqëtarët/et, prokurorët/et dhe profesionistët/et tjerë/a ligjorë/e nuk janë imunë ndaj besimeve shoqërore që shpesh mund të normalizojnë, nënvlerësojnë, apo edhe arsyetojnë dhunën ndaj grave. Nga raportet e RrGK,<sup>4</sup> OSBE,<sup>5</sup> Amnesty International,<sup>6</sup> dhe GLPS,<sup>7</sup> kemi parë që anshmëritë gjinore janë nganjëherë prezente gjatë seancave, vendimeve, apo arsytimit gjyqësor, ku p.sh., gjyqëtarët/et kanë vënë në pikëpyetje sjelljet e viktimave në vend se të kryesve, dhe kanë dështuar të marrin parasysh dinamikat e pabarabarta të pushtetit mes burrave dhe grave që i ndikojnë këto raste.

## Prandaj, përfshirja e pikëpamjes gjinore gjatë monitorimit të seancave dhe vendimeve gjyqësore është jetike.

Përfshirja e dimensionit gjinor në sistemin gjyqësor është më shumë sesa trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në aktet ligjore, apo, siç shprehet nga shumë profesionistë/e ligjorë/e, "trajtimi i viktimave dhe kryerësve 'si palë' gjatë procesit gjyqësor, dhe jo si gjini". Përfshirja gjinore kërkon një përpjekje aktive dhe të kujdesshme për të identifikuar dhe korrigjuar rezultatet e pabarabarta, si dhe për të pranuar se vetë sistemi i drejtësisë është i ndërtuar mbi norma shoqërore që shpesh e tolerojnë apo justifikojnë dhunën ndaj grave. Kjo nënkupton që monitoruesit/et e gjykatave duhet të jenë të pajisur me njohuri dhe mjete që i ndihmojnë ata/o të kuptojnë jo vetëm ligjin, por edhe kontekstin shoqëror dhe ndikimin që ky kontekst ka në mënyrën se si trajtohen rastet në praktikë. Monitorimi gjinor ka të bëjë edhe me analizimin nëse sistemi gjyqësor po kontribuon në drejtësi reale për të mbijetuarit/at, apo po e riprodhon pabarazinë gjinore përmes praktikave të veta.

1.UN Women, Global Database on Violence against Women and Girls (2025). E qasshëm në: <https://data.unwomen.org/global-database-on-violence-against-women>

2.OSCE, "Survey on Wellbeing and Safety of Women in Kosovo" (2019). I qasshëm në: <https://www.osce.org/files/ff/documents/d/c/439781.pdf>

3.FRA, EIGE, Eurostat, "EU Gender-based violence survey- Key Results. Experiences of Women in EU-27" (2024). I qasshëm në: [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/eu-gender\\_based\\_violence\\_survey\\_key\\_results.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/eu-gender_based_violence_survey_key_results.pdf)

4.Rrjeti i Grave të Kosovës, "Nga Ligjet në Vepra: Monitorim i reagimit institucional ndaj dhunës me bazë gjinore në Kosovë" (2021). I qasshëm në: <https://womensnetwork.org/wp-content/uploads/2021/05/KWN-GBV-Report-ALB-final.pdf>

5.OSCE, "Trial monitoring report on the adjudication of domestic violence cases in Kosovo" (2024). I qasshëm në: <https://www.osce.org/files/ff/documents/8/4/572074.pdf>

6.Amnesty International, "Kosovo: From paper to practice – Kosovo must keep its commitments to domestic violence survivors" (2023). I qasshëm në: <https://www.amnesty.org/en/documents/eur73/7123/2023/en/>

7.GLPS, "Towards and Beyond 'No Means No': A Call for Reform in Kosovo's Approach to Rape Cases" (2024). I qasshëm në: <https://legalpoliticalstudies.org/wp-content/uploads/2024/10/GLPS-PA07-A-Call-for-Reform-in-Kosovos-Approach-to-Rape-Cases.pdf>

# ➤ Baza ligjore

Monitorimi i ndjeshëm gjinor i gjykatave duhet të bazohet mbi një kuptim të saktë dhe të thellë të kornizës ligjore dhe strategjike që rregullon përgjegjësinë e institucioneve të drejtësisë në Kosovë. Kjo kornizë përfshinë dokumente që kanë peshë të ndryshme normative, duke filluar nga Kushtetuta si akti më i lartë juridik, legjislacioni penal dhe civil, ligje të posaçme për mbrojtjen nga dhuna në baza gjinore, deri te dokumentet strategjike kombëtare dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë.

Në krye të hierarkisë ligjore qëndron **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**, e cila garanton barazinë para ligjit dhe ndalon çdo formë diskriminimi, përfshirë atë në bazë gjinie.<sup>8</sup> Neni 22 i Kushtetutës përcakton se një sërë instrumentesh ndërkombëtare për të drejtat e njeriut kanë fuqi të drejtpërdrejtë dhe përparësi ndaj ligjeve të tjera vendore,<sup>9</sup> ndërsa Neni 53 kërkon interpretimin e të drejtave dhe lirive themelore në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.<sup>10</sup> Kjo e obligon çdo gjykatë që, përveç legjislacionit vendor, të marrë parasysh edhe standardet dhe interpretimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në legjislacionin ndërkombëtar, Konventa e Stambollit mbetet standardi më i lartë për mbrojtjen nga dhuna në baza gjinore, duke kërkuar mbrojtje të integruar dhe gjithëpërfshirëse për viktimat, ndëshkim efektiv për kryerësit, dhe përpjekje për parandalim të dhunës nga institucionet.<sup>11</sup>

Po ashtu, Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, imponojnë standarde detyruese për eliminimin e diskriminimit dhe mbrojtjen efektive të viktimave.

Sa i përket legjislacionit vendor material, **Kodi Penal i Republikës së Kosovës** është instrumenti tjetër bazë për përcaktimin dhe ndëshkimin e veprave penale që përbëjnë dhunë në baza gjinore. Kodi penal nuk përmbanë ndonjë veprë të veçantë në lidhje me dhunën ndaj grave, por në **Nenin 248** e trajton dhunën në familje si veprë penale.<sup>12</sup> Kodi gjithashtu specifikon se çdo veprë penale e kryer brenda marrëdhënies familjare do të konsiderohet rrethanë rënduese për secilën veprë tjetër.<sup>13</sup>

Përtej veprës së dhunës në familje, Kodi Penal përfshinë një spektër të gjerë veprash që mund të kenë dimension gjinor dhe të përbëjnë dhunë në baza gjinore, në rastet kur përputhen me definimin e DhBGJ-së, sipas Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore.<sup>14</sup> Këto vepra mund të përfshijnë por jo të kufizohen në veprat e Kapitullit XVI- veprat penale kundër jetës dhe trupit,<sup>15</sup> Kapitullit XVII- veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut,<sup>16</sup> Kapitullit XX- veprat penale kundër integritetit seksual,<sup>17</sup> si dhe Kapitullit XXI- veprat kundër martesës dhe familjes.<sup>18</sup>

8. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 23. E qasshme në: [https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se\\_Kosoves.pdf](https://masht.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Kushtetuta.e.Republikes.se_Kosoves.pdf)

9. Id., Neni 22.

10. Id., Neni 53.

11. Këshilli i Evropës, Konventa e Stambollit (2015). E qasshme në: <https://rm.coe.int/168046031c>

12. Kodi Penal i Republikës së Kosovës (2019), Neni 248. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18413>

13. Id., Neni 70, paragrafi 2.14.

14. Shih përkufizimet në Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore, Neni 3. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83131>

15. Në këtë kapitull përfshihen: vrasja (neni 172), vrasja e rëndë (neni 173), vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore (neni 174), vrasja nga pakujdesia (neni 175), vrasja e foshnjës gjatë lindjes (neni 176), shtytja në vetëvrasje dhe ndihma në vetëvrasje (neni 177), ndërpreja e palejuar e shtatëzënisë (neni 178), sterilizimi i detyruar (neni 179), gjymtimi i organeve gjinitale femërore (neni 180), kanosja (neni 181), ngacmimi (neni 182), ngacmimi seksual (neni 183), sulmi (neni 184), lëndimi i lehtë trupor (neni 185), lëndimi i rëndë trupor (neni 186), pjesëmarrja në rrahje (neni 187), mosdhënia e ndihmës (neni 188), braktisja e personave të paaftë (neni 189).

16. Disa nga veprat që përfshihen në këtë kapitull: rrëmbimi (neni 191), shtrëngimi (neni 192), privimi i kundërligjshëm i lirisë (neni 193), fotografimi dhe inçizimet tjera të paautorizuara (neni 202) etj.

17. Në këtë kapitull përfshihen: dhunimi (neni 227), shërbimet seksuale të viktimit të trafikimit (neni 228), sulmi seksual (neni 229), degradimi i integritetit seksual (neni 230), ofrimi i materialit pornografik personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 231), keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi (neni 232), nxitja e akteve seksuale me premtim të rrejshëm të martesës (neni 233), mundësimi ose detyrimi në prostitucion (neni 234), ofrimi i lokaleve për prostitucion (neni 235), marrëdhëniet seksuale brenda familjes (neni 236).

18. Disa nga veprat që përfshihen në këtë kapitull: mundësimi i martesës së kundërligjshme (neni 238), martesa e detyruar (neni 239), bashkësia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet (neni 240) etj.

Sa i përket legjislacionit vendor procedural, **Kodi i Procedurës Penale së Republikës së Kosovës**<sup>19</sup> ka për qëllim të përcaktojë rregullat e detyrueshme për punën e gjykatave, prokurorisë dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale, duke garantuar që çdo procedurë gjyqësore të zhvillohet në mënyrë të drejtë para gjykatës kompetente. Secila procedurë penale duhet të zhvillohet në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, prandaj ky mbetet një dokument kyç për monitorimin e ndjeshëm gjinor. Për rastet e DhBGJ-së, kodi parasheh disa dispozita specifike mbrojtëse. P.sh., kodi ndalon pezullimin e përkohshëm të procedurës dhe ndërmjetësimin në këto raste,<sup>20</sup> parashikon masa të veçanta mbrojtëse<sup>21</sup> dhe kërkon që viktimat e DhBGJ, dhunës në marrëdhënie familjare dhe dhunës seksuale të trajtohen si të ndjeshme gjatë procedurës penale.<sup>22</sup> Po ashtu, viktimës i mundësohet shmangia e kontaktit të drejtpërdrejtë me të pandehurin sa herë që është e mundur gjatë procedurës në polici, prokurori apo gjykatë,<sup>23</sup> dispozitë tepër e rëndësishme për të parandaluar ritraumatizimin dhe për të garantuar një proces të ndjeshëm dhe të sigurt.

Së fundmi, ligji më i ri dhe më i rëndësishëm në këtë fushë është **Ligji Nr. 08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore**, i cili është i harmonizuar me Konventën e Stambollit dhe përfaqëson një qasje gjithëpërfshirëse. Ky ligj përkufizon qartë format e dhunës: fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike dhe institucionale, dhe vendos detyrime të qarta për identifikimin, parandalimin, trajtimin dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.<sup>24</sup> Në përkufizimin për dhunën ndaj grave, ligji saktëson se:

*"Dhuna ndaj grave – kuptohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit ndaj grave dhe do të nënkuptojë të gjitha aktet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë në ose ka të ngjarë të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik apo vuajtje të grave. duke përfshirë kërcënimet për akte të tilla, detyrimin ose privimin arbitrar të lirisë, qoftë në jetën publike apo private"*<sup>25</sup>

Ky ligj po ashtu rregullon në mënyrë të detajuar institutin e urdhrit të mbrojtjes, duke mundësuar një mekanizëm civil për mbrojtjen e viktimave. Ai përcakton llojet e urdhrave të mbrojtjes, procedurën për kërkimin dhe lëshimin e tyre nga gjykatat civile, masat mbrojtëse që mund të përfshihen, si dhe detyrimin për bashkëpunim ndërinstitucional në zbatimin e tyre.<sup>26</sup> Urdhrat e mbrojtjes, të parashikuar në këtë ligj, synojnë të ofrojnë siguri të menjëhershme për viktimat dhe të parandalojnë kontaktin apo dhunën e mëtejshme nga kryesi, duke garantuar një qasje të drejtpërdrejtë dhe të mbështetur në të drejtat e njeriut për mbrojtjen e tyre.

Në praktikë, rruga e një rasti të dhunës në familje mund të ndjekë dy procedura paralele: penale dhe civile. Në procedurën penale, gjithçka nisë me raportimin e dhunës në polici, e cila duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme mbrojtëse dhe të referojë rastin tek prokuroria. Prokuroria heton, ngritë aktakuzën dhe ndjek çështjen në gjykatë. Viktima mund të mbrohet në procedurë nga avokat/e personal/e, apo nga Zyra për Mbrojtjen e Viktimave, në kuadër të Prokurorisë. Në planin civil, viktima mund të kërkojë urdhër mbrojtës mbrojtje të menjëhershme. Të dyja procedurat mund të zhvillohen paralelisht dhe kërkojnë bashkëpunim ndërinstitucional për mbrojtje të plotë dhe të koordinuar.

Hapi i parë dhe i domosdoshëm në çdo monitorim gjyqësor është të sigurohet zbatimi i përpiktë i legjislacionit procedural dhe material. Vetëm pasi të jetë vlerësuar respektimi i ligjit, monitorimi mund të shkojë më tej për të analizuar dimensionin gjinor, duke identifikuar paragjykimet, stereotipet dhe praktikatat që mund të cenojnë barazinë dhe të drejtat e viktimave. Vetëm një monitorim që bashkon zbatimin e ligjit me një analizë të ndjeshme gjinore mund të kontribuojë në ndërtimin e një sistemi drejtësie më të drejtë dhe më të mbrojtës për të gjithë/a.

19.Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (2022). I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocument-Detail.aspx?ActID=61759>

21.Id., Neni 224.

23.Id., Neni 63, paragrafi 1.21.

25.Id., Neni 3, paragrafi 1.2.

20.Id., Neni 229, paragrafi 2.

22.Id., Neni 63, paragrafi 1.4.

24.Shih përkufizimet e Ligji Nr. 08/L-185 në Nenin 3. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=83131>

26.Id., Kapitulli IV- Masat Mbrojtëse dhe Procedura e Shqiptimit të Tyre

# › Disa nocione kyçe

Para se të monitorojmë seancat gjyqësore, është e rëndësishme të kuptojmë disa nga konceptet themelore që formësojnë mënyrën se si ne e interpretojmë dhe shohim dhunën, drejtësinë dhe qasjen institucionale.

## Integrimi i dimensionit gjinor (Gender mainstreaming)

Integrimi i dimensionit gjinor është një praktikë që siguron që të gjitha ligjet, politikat e programet janë të dizajnuara dhe implementuara në atë mënyrë që merr parasysh dallimin në nevoja dhe përvoja mes personave të gjinive të ndryshme. Kjo nuk do të thotë të trajtojmë çdo person në mënyrë "të njëjtë", por të njohim se njerëzit afektohen ndryshe nga fenomene të ndryshme, bazuar në gjininë e tyre, dhe pastaj të përshtatim sistemin në mënyrë që të përgjigjet në këtë dallim.

■ **Shembull:** Për shkak të roleve tradicionale gjinore dhe ndarjes së pabarabartë të punës e kujdesit të papaguar, gratë shpesh mund përballen me kufizime në kohë apo në lëvizshmëri që u pengojnë të kenë qasje në shërbimet e ndihmës juridike gjatë orarit standard të punës, apo lokacioneve të centralizuara. Prandaj, një program i ndihmës juridike që integron dimensionin gjinor, do të ofronte shërbime të lëvizshme, orare fleksibile dhe prani në hapësira të komunitetit. Kjo përshtatje, duke njohur pengesat strukurorë me të cilat përballen gratë, do të siguronte qasje më të barabartë në drejtësi për gratë.



Sipas Institutit Evropian për Barazi Gjinore, integrimi i dimensionit gjinor paraqet:

*"Shqyrtimin sistematik të dallimeve mes kushteve, situatave dhe nevojave të grave dhe të burrave në të gjitha veprimet dhe politikat."*<sup>27</sup>

## Ndërthurshmëria (Intersectionality)

Ndërthurshmëria është një kornizë që njeh se si aspekte të ndryshme të identitetit të një personi, si p.sh. gjinia, raca, etniciteti, mosha, orientimi seksual etj., ndërthuren dhe krijojnë përvoja unike të diskriminimit apo privilegjit. Në kontekst të drejtësisë dhe DhBGj-së, ndërthurshmëria na ndihmon të kuptojmë se jo të gjitha viktimat e përjetojnë dëmin në mënyrë të njëjtë.

■ **Shembull:** Një grua me aftësi të kufizuara që përjeton dhunë mund të hasë barriera të shumëfishta për të raportuar rastin e saj në mënyrë efektive. Ajo mund të mos ketë qasje fizike në ndërtesat publike si stacionet e policisë apo gjykatat, të mos ketë përkrahje të duhur për të komunikuar nëse ka vështirësi të të folurit apo dëgjimit, dhe mund të paragjykohet nga autoritetet si "e paaftë" për të dhënë dëshmi të besueshme. Këto pengesa strukurorë dhe shoqërore mund të ndikojnë drejtpërdrejt në përvojën e saj unike me drejtësinë.



Sipas Institutit Evropian për Barazi Gjinore ndërthurja është:

*"Mjet analitik për të studiuar, kuptuar dhe reaguuar ndaj mënyrës se si seksi dhe gjinia ndërthuren me karakteristikat/identitete të tjera personale dhe si këto ndërthurje kontribuojnë në përvoja unike të diskriminimit"*<sup>28</sup>

Një grua transgjinore që përjeton dhunë për shkak të identitetit të saj gjinor mund të përballen me rreziqe shtesë, përfshirë mosrespektimin e identitetit të saj gjinor në polici dhe gjykatë, vendosjen në ambiente të pasigurta si p.sh. në qendra për burra, si dhe mungesën e mbështetjes së përshtatshme psikologjike dhe ligjore. Ajo mund të përjetojë mosbesim institucional, paragjykim dhe ekskluzion që e pengojnë të ketë qasje të barabartë në drejtësi.

Një grua serbe që përjeton dhunë dhe jeton në një komunë me shumicë shqiptare mund të përballen me barriera gjuhësore, mosbesim institucional dhe stigmatizim për shkak të përkatësisë së saj etnike. Ajo mund të mos ndihet e sigurt për të raportuar rastin, të përjashtohet nga informacioni i rëndësishëm për të drejtat dhe procedurat në gjuhën e saj amtare, ose të përballen me mungesë të përkthimit cilësor gjatë seancave. Këto sfida mund të ndikojnë në gatishmërinë dhe aftësinë e saj për të kërkuar drejtësi në mënyrë të barabartë.

27. European Institute for Gender Equality, Glossary and Thesaurus. I qasshëm në: <https://eige.europa.eu/publications-resources/thesaurus/terms/1070>

28. European Institute for Gender Equality, Glossary and Thesaurus. I qasshëm në: <https://eige.europa.eu/publications-resources/thesaurus/terms/1050>

## Stereotipet

Stereotipet janë ide të fiksuara për një grup të njerëzve, që injorojnë dallimet individuale dhe realitetet individuale. Në kontekst gjinor, ato ju referohen paragjytimeve apo pritshmërive për se si duhet të sjellen, duken, flasin apo jetojnë gratë apo burrat, bazuar vetëm në gjininë e tyre. Këto paragjytime, kur aplikohen në sistemin gjyqësor rezultojnë në trajtim të anshëm dhe viktimizim të dytë.

■ **Shembull:** Një prokuror/e vë në dyshim kredibilitetin e një viktime të dhunimit bazuar në stilin e veshjes së saj. Ose një gjyqtar/e paragjykon që për faktin se një grua është kthyer të jetojë me dhunuesin e saj, ajo nuk ka qenë viktimë e dhunës fare, duke implikuar që ajo ka ekzagjëruar rastin para gjykatës.



Sipas Institutit Evropian për Barazi Gjinore, një stereotip gjinor definohet si:

*"Praktika e atribuimit të tipareve, karakteristikave apo roleve të caktuara ndaj grave apo burrave, vetëm mbi bazën e përkatësisë së saj apo të tij në grupin shoqëror të grave apo burrave."<sup>29</sup>*

## Viktimizimi i dytë (apo riviktimizimi)

Viktimizimi i dytë ndodhë kur një viktime të dhunës, përsëri i shkaktohet dëm emocional, psikologjik apo institucional, nga mënyra se si institucioni apo sistemi e trajton rastin saj/tij. Kjo ndodhë p.sh. kur viktima detyrohet të japë në mënyrë të përsëritur dëshmi të dhunës, të përballet me paragjytime nga sistemi, me mangësi në mbështetje, apo procedura tjera që rivendosin traumën e saj/tij.

■ **Shembull:** Gjatë një procesi gjyqësor për një rast të DhBGj-së, viktimës i kërkohet të përmendë detaje të ndjeshme nga rasti disa herë, nga profesionistë/e të ndryshëm/me ligjorë/e, p.sh., zyrtari/ja i/e policisë, prokurori/ja, dhe pastaj përsëri para gjykatës. Secilën herë pyetjet janë tendencioze, duke u fokusuar në sjelljen e viktimës në vend se në veprimet e dhunuesit. Në një pikë, avokati/ja mbrojtës/e e dhunuesit sugjeron që viktima "kishte provokuar" dhunën dhe gjyqtari/ja nuk intervenon. Po ashtu, para seancës, viktima detyrohet të ulët në vendin e njëjtë me kryesin duke pasur kontakt direkt me të, duke shkaktuar shqetësim të dukshëm. Kjo situatë krijon dëm përtej abuzimit fillestar, viktima ndihet e përlulur, e fajësuar, dhe e pasigurt, duke përbërë një viktimizim të dytë nga sistemi i drejtësisë, dhe krijon traumë (edhe kur nuk e ka këtë qëllim).



Sipas Institutit Evropian për Barazi Gjinore, *"Viktimizimi i dytë ndodh kur viktima pëson dëme të mëtejshme jo si rezultat i drejtpërdrejtë i aktit kriminal, por për shkak të mënyrës se si institucionet dhe individët e tjerë trajtojnë viktimën. Viktimizimi i dytë mund të shkaktohet, për shembull, nga ekspozimi i përsëritur i viktimës ndaj kryesit të veprës, nga marrja në pyetje e përsëritur lidhur me të njëjtat fakte, përdorimi i gjuhës së papërshtatshme ose komentet jo të ndjeshme të bëra nga të gjithë ata që vijnë në kontakt me viktimat."*

## Qasja me viktimën në qendër

Një sistem që ka viktimën në qendër, vendosë nevojat, të drejtat, dhe dinjitetin e viktimës në qendër të secilës fazë të procesit ligjor, nga raportimi deri në aktgjykimin e plotëfuqishëm. Kjo do të thotë që të gjitha procedurat, vendimet, ndërveprimet janë të dizajnuara për të minimizuar dëmin dhe respektuar viktimën. Një qasje me viktimën në qendër përfshinë:

- Sigurinë që viktimat trajtohen me respekt, empati dhe dinjitet;
- Ofrimin e informatave të qarta për të drejtat e viktimave dhe procesin në tërësi
- Minimizimi i rritraumatizimit përmes marrjes në pyetje të kujdesshme, urdhërave mbrojtës, dhe procesit gjyqësor të ndjeshëm gjinor.
- Fuqizimi i viktimave për të marrë pjesë vullnetarisht në procesin gjyqësor, pa presion apo pa fajësim të viktimave.

➤ Konventa e Stambollit obligon palët që të garantojnë vendosjen e të drejtave të viktimave në qendër të të gjitha masave që merren kundër dhunës.

<sup>29</sup>.European Institute for Gender Equality, Glossary and Thesaurus. I qashtëm në: <https://eige.europa.eu/publications-resources/thesaurus/terms/1371>

# › Çka të kërkojmë në seancat gjyqësore?

Përveç zbatimit të përpiktë të legjislacionit procedural dhe meritor, duhet të monitorohen edhe këto çështje me dimension gjinor:

## 1. Prezenca dhe trajtimi i viktimave

Prania dhe mënyra e trajtimit të viktimave në seanca ndikon drejtpërdrejt në sigurinë, dinjitetin dhe gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në procesin gjyqësor. Salla e gjykatës nuk duhet të jetë një hapësirë frikësuese apo e mbyllur për viktimat, përkundrazi, ajo duhet të ofrojë mbështetje, siguri dhe respekt. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës se si profesionistët/et ligjorë/e i adresojnë dhe i përfshijnë viktimat në proces, si dhe nëse ambienti fizik dhe ndërveprimet mbështesin një qasje të ndjeshme gjinore dhe ndaj traumës.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- A janë viktimat prezente?
- Si po trajtohen ato nga profesionistët/et ligjorë/e? – Të monitorohet sjellja, toni dhe gjuha e trupit
- A është ambienti në gjykatë miqësor për viktimat? – Ambienti mund të fuqizojë apo të heshtë viktimat.
- A po mbrohen viktimat nga kontaktet e panevojshme me kryesit?
- A kanë viktimat mbrojtjen e duhur? Nëse mbrojtja ju ofrohet nga ZMV-të, a janë ata/o aktivë/e në mbrojtje dhe a i informojnë viktimat me të drejtat e veta?

## 2. Gjuha dhe qasja nga profesionistët/et ligjorë/e

Gjuha e përdorur dhe mënyra e ndërveprimit të profesionistëve/eve ligjorë/e me viktimat kanë ndikim të madh në përvojën e viktimës dhe në drejtësinë e procesit. Gjuha bartë me vete qëndrime, bindje dhe shpeshherë edhe paragjykime të pavetëdijshme. Në rastet e dhunës në baza gjinore, përdorimi i një gjuhe të ndjeshme, të respektueshme dhe jo-fajësuese është thelbësor për të shmangur ritraumatizimin dhe për të garantuar një proces të drejtë. Për më tepër, paragjykimet e pavetëdijshme ndaj gjinisë, sjelljes “të pritshme” apo rolit tradicional në familje të grave dhe burrave mund të ndikojnë si në vlerësimin e kredibilitetit të palëve, ashtu edhe në mënyrën se si zhvillohet seanca. Monitorimi i këtyre elementeve ndihmon të identifikohen praktikat që mund t'i dëmtojnë viktimat dhe ta përforcojnë pabarazinë gjinore.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- A është gjuha që përdoret në gjykatë e ndjeshme ndaj viktimave? A përdoret gjuhë diskriminuese? – Gjuha reflekton qëndrimet institucionale ndaj roleve gjinore dhe kredibilitetit.
- A është gjuha që përdoret fajësuese apo minimizuese ndaj përjetimit të viktimës?
- A përdoren stereotipe për sjelljet “tipike” të grave apo burrave në lidje me rastin? Stereotipet janë paragjykime, dhe si të tilla afektojnë trajtimin e drejtë dhe të paanshëm.
- A ndërpriten viktimat kur janë duke folur?
- A ka ndërveprime mes viktimave dhe kryesve gjatë seancave? Nëse po, a ndërhyjnë gjyqtari/ja për të ngritur sigurinë e viktimës?
- A portretizohen viktimat duke u përdorur stereotipet gjinore?
- Si sjellen avokatët/et, përkthyesit/et, punëtorët/et socialë/e me viktimat?

### 3. Ndjeshmëria ndaj traumës

DhBGj lë pasoja të thella psikologjike dhe emocionale te viktimat, të cilat mund të shfaqen gjatë procesit gjyqësor. Prandaj, profesionistët/e ligjorë/e duhet të demonstrojnë ndjeshmëri ndaj traumës dhe të tentojnë që procedurat të mos përkeqësojnë gjendjen emocionale të viktimës. Mungesa e kësaj ndjeshmërie rrezikon riviktimizimin. Gjithashtu, lejimi i pyetjeve që fajësojnë ose nënçmojnë viktimën e minon procesin dhe dëmton rëndë integritetin e viktimës. Monitorimi i këtyre elementeve është thelbësor për të vlerësuar nëse gjykata siguron një qasje të kujdesshme, të dinjitetshme dhe të ndjeshme ndaj përvojave të dhimbshme të viktimave.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- A shfaqin gjyqtarët/et, prokurorët/et, dhe profesionistët/et ligjorë/e ndjeshmëri ndaj traumës gjatë marrjes në pyetje dhe ndërveprimeve me viktimat?
- A ka ndjeshmëri nga ritraumatizimi potencial? A i jepet vëmendje gjendjes emocionale të viktimës, a i jepet pushim, ujë etj?
- A lejohen avokatët/et mbrojtës/e të të pandehurve/ave të bëjnë pyetje të cilat sulmojnë direkt traumën e viktimave?

### 4. Aspektet procedurale

Drejtësia që vonohet, shpesh është drejtësi që mohohet, veçanërisht për viktimat e DhBGj, për të cilat proceset gjyqësore të zvarritura mund të nënkuptojnë stres të vazhdueshëm, pasiguri, probleme me strehim dhe trajtim të traumës. Monitorimi i aspekteve procedurale ndihmon të kuptojmë sa efektivisht dhe me ndjeshmëri funksionon sistemi i drejtësisë në raport me viktimën. Shtyrjet e shpeshta, mungesa e përditësimit për viktimat, dhe praktikat si referimi në ndërmjetësim kur ka dhunë, mund të dëmtojnë besimin e viktimave në institucione dhe të pamundësojnë qasjen e tyre reale në drejtësi.

Përveç përputhshmërisë me Kodin për Procedurën Penale dhe Kodin për Procedurën Civile, mund të trajtohen edhe këto elemente:

- Sa shpesh po caktohen seancat gjyqësore? A ka shtyrje të shpeshtë të seancave?
- Me sa seanca po përfundojnë rastet?
- A janë viktimat të përditësuar dhe të përfshira në proces?
- A referohen viktimat në ndërmjetësim, ose a përmendet "pajtimi" mes viktimës dhe kryesit si opsion?

### 5. Pjesëmarrja e grupeve tjera të marginalizuara

Për të siguruar drejtësi të barabartë për të gjithë, monitorimi duhet të vlerësojë nëse sistemi gjyqësor merr parasysh nevojat specifike të grupeve të marginalizuara. Gratë nga komunitetet joshumicë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, apo viktimat që nuk flasin gjuhën zyrtare, shpesh përballen me barriera shtesë gjatë qasjes në drejtësi. Mungesa e përkthimit, e aksesit fizik në institucione, apo mosmarrja parasysh e moshës apo gjendjes shëndetësore, mund të përjashtojë viktimat nga procesi ose t'i bëjë ato të ndihen të padukshëm.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- A ka shërbime përkthimi dhe interpretimi në dispozicion kur viktimat nuk flasin shqip?
- A është gjykata e qasshme për personat me aftësi të kufizuara?
- A janë fëmijët e përfshirë dhe a janë nevojat e tyre të përmbushura?

# › Çka të kërkojmë në aktgjykime?

Aktgjykimet përfaqësojnë momentin përfundimtar të procesit gjyqësor dhe ofrojnë pasqyrë të drejtpërdrejtë mbi mënyrën se si gjykatat interpretojnë ligjin, e kuptojnë DhBGj-në, dhe i qasen viktimës. Përmes analizës së tyre, mund të kuptojmë nëse vendimet gjyqësore janë ndërtuar mbi stereotipe, mungesë të ndjeshmërisë gjinore, apo qasje të pabarabarta ndaj palëve. Monitorimi i aktgjykimeve ndihmon të nxjerrim në pah qasjen sistematike të gjykatës ndaj drejtësisë me dimension gjinor.

Përveç zbatimit të përpiktë të legjislacionit procedural dhe merit, duhet të monitorohen edhe këto çështje me dimension gjinor:

## 1. Arsyetimet gjyqësore dhe gjuha e përdorur

Gjuhës dhe arsytimit të përdorur në aktgjykime duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë, pasi ato zbulojnë qëndrimin e gjykatës ndaj krimit dhe viktimës. Përdorimi i rrethanave lehtësuese për kryesin si kërkimi i faljes apo pendesa, apo trajtimi i vetëmbrojtjes si dhunë reciproke, mund të çojë në normalizim të dhunës dhe në mosmbrojtje të viktimave.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- Cilat janë arsyetimet e ofruara për llojin e dënimit?
- Cilat janë rrethanat lehtësuese të përdorura në arsyetim?
- A po përdoren "kërkim falja" dhe "pendesa" si rrethana lehtësuese? A ndodhë një gjë e tillë edhe nëse kemi të bëjmë me recedivizëm? A po vlerësohet "pendesa" në ndonjë mënyrë nga gjykata, apo merret vetëm si fjalë goje?
- A ka raste kur të dy personat shpallen të fajshëm për dhunë në familje, edhe nëse viktima ka sulmuar/lënduar kryesin me anë të vetëmbrojtjes?

## 2. Njohja e recedivizmit dhe trendeve të abuzimit

Për të garantuar mbrojtje efektive dhe afatgjatë për viktimën, është jetike që gjykata të identifikojë dhe ta trajtojë dhunën si një sjellje e përsëritur dhe jo si një incident i izoluar. Në shumë raste të DhBGj-së, veçanërisht në kontekstin e dhunës në familje, dhuna ndodhë në mënyrë ciklike, me shkallëzim të rrezikut me kalimin e kohës para raportimit të saj. Nëse aktgjykimi dështon të evidentojë historikun e sjelljeve të dhunshme të kryesit, atëherë

rrezikohet jo vetëm besueshmëria e vendimit, por edhe siguria e viktimës pas procesit gjyqësor. Mosnjohja e recedivizmit mund të sjellë vendime të buta që nuk pasqyrojnë rrezikun real që paraqet kryesi. Gjithashtu, mund të ndodhë që gjykata të mos rekomandojë masa mbrojtëse apo të mos aplikojë rrethana rënduese në dënim, duke injoruar tendencat e përsëritura të dhunës.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- A përmendet në aktgjykim nëse kryesi ka një histori të dhunës?
- A njihet sjellja e mëparshme apo dhuna e vazhdueshme si rrethanë rënduese?

### 3. Kuptimi i krimit me dimension gjinor, vendosja e fajit dhe përgjegjësia

Vendosja e drejtë e fajit dhe përgjegjësia është thelbësore për të ruajtur integritetin e sistemit të drejtësisë dhe për të siguruar besimin e viktimave në institucionet gjyqësore. Aktgjykimet që, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i atribuojnë përgjegjësinë viktimës, për shembull duke sugjeruar se ajo ka provokuar dhunën, apo duke ngritur dyshime mbi karakterin dhe qëllimet e saj, tregojnë mungesë të thellë të kuptimit të natyrës dhe kontekstit të DhBGj-së. Një qasje e tillë jo vetëm që

rrezikon të ritraumatizojë viktimën, por gjithashtu krijon precedent që pengojnë raportimin e rasteve të ngjashme në të ardhmen. Në aktgjykime, gjyqtarët/et duhet të demonstrojnë qartësi në ndarjen e përgjegjësia dhe të shmangin çdo lloj retorike apo logjike që përforcon stereotipe gjinore, duke garantuar që fajësia të mbështetet mbi prova të qarta dhe analiza të paanshme të fakteve.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- A e vendosë gjykata fajin tek viktimja (duke sugjeruar që kanë provokuar dhunën)?
- A portretizohet viktimja si e pabesueshme, apo jostabile emocionalisht?
- A fajësohet viktimja për mosraportim më të hershëm, apo për vazhdimin e qëndrimit në një ambient me dhunë? A përmendet kjo në disfavor të viktimës?
- A reflekton aktgjykimi një kuptim të dinamikave të pushtetit në DhBGj? A e trajton dhunën si një çështje private a familjare, në vend se një formë e ushtrimit të kontrollit?
- A e adreson gjykata ndikimin e dhunës në viktimën?

### 4. Definimi i koncepteve ligjore

Mënyra se si konceptet juridike interpretohen në aktgjykime ka ndikim të madh në përvojën e viktimave dhe në realizimin e drejtësisë materiale. Terma si "pëlqimi" apo "provokimi" nuk janë të padëmshëm kur përdoren pa një kuptim të ndjeshëm ndaj kontekstit gjinor. Përdorimi i "provokimit" si rrethanë lehtësuese në rastet e dhunës në familje, për shembull, mund të kontribuojë në fajësimin e viktimës dhe në uljen e përgjegjësia së kryesit. Po ashtu, mungesa e një interpretimi të qartë dhe gjithëpërfshirës të konceptit të "pëlqimit" çon shpesh në vendime që nuk e

pasqyrojnë realitetin e viktimave, veçanërisht në dhunën seksuale. Në shumë raste, gjykatat vijojnë të bazojnë vlerësimin e pëlqimit vetëm në faktin nëse viktimja ka rezistuar fizikisht, duke injoruar kontekste ku viktimja ka thënë "jo", ka ngrirë nga frika, apo është ndjerë e paaftë të kundërshtojë. Kjo qasje përjashton përvojat e shumta të viktimave të cilat nuk janë në gjendje të reagojnë fizikisht dhe minimizon dhunën që nuk lë shenja fizike, por është po aq reale dhe e dëmshme.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- Tek veprat kundër integritetit seksual, a është interpretimi i "pëlqimit" konform me definimin e tij në Kodin Penal?
- A interpretohet ligji me standarde anti-diskriminim?
- A referencohet praktika e GjEDNj-së, apo standardet ndërkombëtare të të drejtave ligjore në aktgjykime?

## 5. Mbrojtja e mëtejme e viktimës

Një aktgjykim që reflekton drejtësi gjinore nuk përfundon vetëm me vendosjen e fajësisë apo pafajësisë së kryesit, ai duhet të garantojë gjithashtu mbrojtjen dhe mirëqenien e viktimës pas përfundimit të procesit. Kjo përfshinë sigurimin e vazhdueshëm fizik dhe emocional, si dhe lehtësimin e qasjes në mekanizmat mbështetës institucio-

nalë e shoqërorë. Gjykatat që nuk adresojnë aspektin e mbrojtjes së viktimës, në veçanti në rastet e dhunës në baza gjinore, rrezikojnë të lënë hapësirë për vazhdimësinë e dhunës ose për ritraumatizim.

Disa pyetje udhëzuese që ndihmojnë në vlerësimin e kësaj fushe:

- A përmendet mbrojtja dhe ofrimi i sigurisë për viktimën në aktgjykim?
- A rekomandon/lehtëson gjykata qasjen në shërbime të ndryshme për viktimat? (Strehimore, mbështetje psikologjike etj.)
- A ofrohet kompensimi në rastet që është i aplikueshëm?
- A lëshohen urdhërat mbrojtës bazuar në aktgjykim?
- A ka ndonjë strategji për vlerësim të rrezikut apo masa monitoruese të propozuara?







Funded by  
the European Union

Udhëzues për Monitorim të  
Ndjeshëm Gjinnor të Gjykatave në  
Rastet e Dhunës në Baza Gjinnore



GRUPI PËR STUDIME  
JURIDIKE DHE  
POLITIKE